

Rovena VATA

FIGURA E SKËNDERBEUT MES HISTORISË DHE LETËRSISË- (TREGIMI: ËNDRRA E SKËNDERBEUT) ME AUTOR GJIKË KUQALI

UDC 821.133.1:929Skenderbeg

Abstrakt: Gjikë Kuqali është autori i tregimit Ëndrra e Skënderbeut, një shkrimtar dhe dëshmor i Luftës së Dytë Botërore. Ai lindi në Korçë dhe vdiq i pushkatuar nga nazistët në kampin nazist të Prishtinës.

Me këtë tregim autori në fjalë na e sjell figurën e Skënderbeut në dy dimensione: në dimensionin historik dhe në atë letrar. Në aspektin historik ai fakton se ishte kohë lufte, ambjenti ishte i mbushur me ushtarë dhe oficer dhe që Skënderbeu ishte kryegjenerali i ushtrisë turke dhe që po pushonte i qetë në çadrën ushtarake. Ndërsa në aspektin letrar na rrëfen se gjatë pushimit të tij në çadër Skënderbeut i shfaqej një dritë e bardhë dhe më pas një fytyrë njeriu shumë e lodhur, që afrohej në drejtim të tij. Ajo ishte një grua rrudha-rrudha, me sy të fytyrë e të nxirë, më flokë të lëshuar dhe të ngatërruar, e veshur me një plaçkë të zezë, lyer me gjak, e çarë dhe e grisur, e ngjitur pas trupit të saj aq të dobët. Fjalët mezi i dilnin nga goja, por ajo arriti t'i fliste kryegjeneralit duke i thënë: Jam Shqipëria, unë vetë Shqipëria! Jam nëna jote, prej meje linde nga vendet e mia ke marr jetë...

Në këtë kumtesë përmes metodës së krahasimit do sjellim në vëmendje perceptimin e figurës së Skënderbeut nga ana historike gjatë qëndrimit të tij në Turqi dhe përfytyrimin letrar, që ai kishte për Shqipërinë dhe që Shqipëria kishte për birin e saj, në shërbim të ushtrisë turke.

Fjalët kyçe: Kryegjeneral, biri i Kastriotëve, Shqipëria, flamuri, shqiponjë

THE SCANDERBEG FIGURE BETWEEN HISTORY AND LITERATURE- (THE STORY: SCANDERBEG'S DREAM) BY GJIKË KUQALI

Abstract: Gjikë Kuqali is the author of the story Ëndrra e Skënderbeut (Skanderbeg's Dream); he is a writer and witness of World War II. He was born in Korca and was shot by the Nazis at the Nazi camp in Pristina.

With this story, the author in question brings the Skanderbeg figure into two dimensions: historical and literary dimensions. Historically, he points out that it was a time of war, full of soldiers and officers everywhere, and Skanderbeg- the military commander of the Turkish Army, was quietly resting in the military tent. Literally, Gjikë narrates that while Skanderbeg was resting in his tent, a white light appeared and then a very tired person was approaching him. She was a wrinkled woman with bruised eyes and face, loose and messy hair, dressed in a black cloth, which was covered in blood, torn and ripped, attached to her skinny body. She could barely speak, but she managed to tell the commander these words; "I am Albania, I am Albania itself! I am your mother, who gave birth to you and in my land you received life..."

In this writing, we will bring in your attention the historical perception of Skanderbeg's figure, during his stay in Turkey and the literary vision he had for Albania and that Albania had for its son, who was serving the Turkish army.

Keywords: Commander, son of the Kastriots, Albania, flag, eagle

Ky seminar albanologjie, si dhe shumë të tjerë për gjatë këtij viti të rëndësishëm të quajtur si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, përkon gjithashtu me 140 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si dhe me vitin jubilar të dhjetëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Figura e heroit tonë kombëtar, Skënderbeu, dhe kujtimi i luftërave të tij të lavdishme kundër turqve, vazhdojnë të ruhen të gjalla në zemrën dhe mendjen e popullit, në këngët, legendat dhe tregimet e bukura, që ka krijuar në shekujt e kaluar dhe deri në ditët tona. Këto krijime artistike kanë një vlerë të madhe, jo vetëm për anën e tyre estetike, për frymën patriotike që i përshkon, por edhe si dokumente, ku populli ka fiksuar ngjarjet e rëndësishme, që lidhen me emrin e heroit legjendar.

Në këtë kumtesë jemi ndalur në trajtimin e figurës së heroit tonë historik Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, të paraqitur në një tregim të një shkrimtari nga Korça, Gjikë Kuqali, i cili u pushkatua nga nazistët në Prishtinë, dhe që ra dëshmor gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Përmes metodës kooperative do sjellim në vëmendje perceptimin e figurës së Skënderbeut nga ana historike gjatë qëndrimit të tij në Turqi dhe përfytyrimin letrar, që ai kishte për Shqipërinë dhe që Shqipëria kishte për birin e saj, në shërbim të ushtrisë turke.

Me këtë tregim autori në fjalë na e sjell figurën e Skënderbeut në dy dimensione: në dimensionin historik dhe në atë letrar.

Në aspektin historik ai fakton se ishte kohë lufte, ambienti ishte i mbushur me ushtarë e oficerë dhe që Skënderbeu ishte kryegjenerali i ushtrisë turke dhe që po pushonte i qetë në çadrën ushtarake. Ndërsa në aspektin letrar na rrëfen se gjatë pushimit të tij në çadër, Skënderbeu i shfaqej një dritë e bardhë dhe më pas një fytyrë njeriu shumë e lodhur, që afrohej në drejtim të tij. Ajo ishte një grua rrudha-rrudha, me sy të fytyrë e të nxirë, më flokë të lëshuar dhe të ngatërruar, e veshur me një plaçkë të zezë, lyer me gjak, e çarë dhe e grisur, e ngjitur pas trupit të saj aq të dobët. Fjalët mezi i dilyn nga goja, por ajo arriti t’i fliste kryegjeneralit, duke i thënë: Jam Shqipëria, unë vetë Shqipëria! Jam nëna jote, prej meje linde nga vendet e mia ke marr jetë.

Puna e një shkrimtari nuk është të tregojë atë që ka ndodhur, po atë që mund të ndodhte, d.m.th, gjërat që mund të ngjasin sipas gjasës ose nevojës. Historiani dhe shkrimtari, ndryshojnë nga njëri-tjetri, pasi historiani rrëfen ç’ngjan e shkrimtari si mund të ngjajë, shprehet Aristoteli te vepra e tij “Poetika”.

Studimet ndër vite që i janë bërë kësaj figurë historike, padyshim se kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për të ndërtuar biografinë e heroit dhe karakteristikat themelore të epokës së tij, për të sqaruar rolin e tij në bashkimin e popullit shqiptar dhe formimin e një shteti të centralizuar, për të gjetur të vërtetën mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Skënderbeut dhe rolin ndërkombëtar të luftës heroike të udhëhequr prej tij. Shkenca historike dhe ajo filologjike mbetet të bëjnë më shumë përpjekje të mëtejshme për studimin e epokës dhe të figurës së heroit tonë, si një nga figurat e mëdha që la gjurmë të pashlyeshme në historinë e Ballkanit dhe të Evropës, por edhe ndikimet e tij mbi jetën politike e kulturore të këtyre popujve.

Veçanërisht, shkencës së sotme i takon të kapërcejë njëanësinë e studimeve të mëparshme, i takon të bëjë rivlerësimin e vlerave, duke u nisur nga pozita metodologjike të shëndosha e objektive, që bëjnë të mundur rishqyrtimin e pikëpamjeve të atyre autorëve, të cilët në një mënyrë ose në tjetrën janë përpjekur t’ia errësojnë luftës heroike të Skënderbeut karakterin e saj kombëtar, rolin e madh të saj

për mbrojtjen e vlerave kulturore të Evropës në kohën e Rilindjes dhe ta shtrembërojë ose ta vënë atë vetëm nën shenjën e kryqit¹.

Autori në fjalë, na ka lënë dy krijime me temë nga epoka e heroit kombëtar “Ëndrra e Skënderbeut dhe “Kthimi i Skënderbeut”, të lidhura ngushtë nga pikëpamja tematike në mes tyre. Autori ka zgjedhur një moment të rëndësishëm në jetën e kryetrimt, çastin kur ai merr vendim për të braktisur nderimet e huaja, por të hidhura të armiqve dhe kthimin e tij të prekshëm në atdhenë që e prët krahëhapur.

Skënderbeut, si gjithë heronjtë në histori, është pjellë e kohës dhe e popullit të vet. Ai doli në skenë, kur përpjekjet e popullit tonë për të mbrojtur lirinë kishin dështuar, por në mendje e në zemër të tij vazhdonin të vlonin të pashuara dashuria për liri e pavarësi, për atdhe e dinjitet njerëzor, për nder e krenari kombëtare, besimi në drejtësinë e çështjes dhe në forcat e veta vendosmëria për ta bërë realitet detyrën e shenjtë të çlirimit nga robëria turke. Skënderbeu i kuptoi me mirë se kushdo tjetër këto aspirate dhe, i ftuar nga populli, në krye të popullit dhe se bashku me popullin, bëri atë që bëri, mrekullinë shqiptare të shek. XV².

Epoka e Skënderbeut, një nga faqet më të ndritura të historisë kombëtare, ishte një gur prove i aftësive dhe i vitalitetit të popullit tonë.

Gjergj Kastrioti i detyroi të gjithë shekujt të flasin për të. Dhe çdo shekull, çdo epokë ka folur me zërin e saj, sepse me syrin e saj ka zbuluar tek ai diçka të re.

Letërsia artistike për Skënderbeun nuk është më pak e pasur se ajo historike e publicistike-filozofike. Me heroizmin dramatik të jetës së tij, me idealet e larta që mbrojti, Gjergj Kastrioti hyri në letërsinë gojore, në legjendat e në këngët e popullit shqiptar e të popujve të tjerë të Ballkanit-që kur ishte gjallë.

Pa dyshim, tiparet themelore të veprave letrare mbi Skënderbeun lidhen si me kushtet historiko-shoqërore të periudhave, në të cilat u krijuan, ashtu edhe me rrymat letrare që lulëzuan në Evropë në këto periudha. Ndër to poezia mbizotëron mbi prozën, drama neoklasiciste mbi dramën e vërtetë historike, romantizmi mbi realizmin. Me gjithë veçoritë e tyre dhe evolucionin që ka pësuar trajtimi artistik i figurës së heroit gjatë shekujve, këto vepra i bashkon një element themelor: në të gjitha ato Skënderbeu del kurdoherë një hero pozitiv, një karakter i fuqishëm, sa trim aq edhe zemërgjerë, me një fjalë, një gjeni i mirë që del fitues në të gjitha rrethanat mbi forcat e së keqes.

Autori e fillon tregimin kushtuar Skënderbeut me përshkrimin armëpushimit, duke kujtuar se lufta kishte mbaruar dhe qetësia ndihej kudo.

“Lufta kish mbaruar. Qetësia kish filluar të binte kudo. Ushtarët, oficerët, të gjithë po mblidheshin nëpër çadëret e tyre. Rojat ecnin andej-këtej dhe burizani lajmëronte me tinguj të lehtë kohën e fjetjes” f. 105.

Më pas autori rrëfen për gjendjen shpirtërore dhe psikologjike të heroit dhe na kujton se ai ishte kryegjenerali i ushtrive turke, çka do të thotë se ai ishte akoma në tokat turke.

“I lodhur, i kapitur, Skënderbeu, kryegjenerali i ushtrive turke, u shtri të flinte ngadhënjimtar. Fitimi nuk kish shtënë në zemrën e tij gëzimin e përhershëm, e kish tronditur më shumë. Nga një dritare e çadrës, ku ishte shtrirë, shikonte jashtë”, f. 105.

¹ Kahreman Ylli, *Fjala e hapjes së konferencës II të studimeve albanologjike nga rektori i Universitetit shtetëror të Tiranës*, në: Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 9-10.

² Stefan Prifti, *Figura e Skënderbeut të Barletit-simbol i popullit të vet*, në: “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 471.

Epoka e Skënderbeut me të drejtë mban emrin e tij, pasi është nga epokat më vendimtare të historisë sonë kombëtare, në të cilën masat popullore, nën udhëheqjen e Skënderbeut, për dhjetëra vjet me radhë luftuan për mbrojtjen e tokës, të lirisë dhe të pavarësisë së vet, duke i vënë themele të qëndrueshme asaj ndërtese, që brezat e ardhshëm e çuan deri në fund: bashkimit të popullit shqiptar në shtetin e tij kombëtar. Ne përkujtojmë epokën e Skënderbeut si një pjesë të asaj lufte të madhe, në të cilën popujt e Evropës Juglindore, e midis tyre në radhët e para populli shqiptar, duke luftuar për tokën e lirinë e vet, u bënë një ledh mbrojtës për të ndalur vërshimin shkatërrues të agresionit të sulltanëve osmanë të shek. VX, agresion që vinte në rrezik fatet e qytetërimit evropian në përgjithësi¹.

Në kohë qetësie Skënderbeu mendonte luftën, barutin, pushkët, buçitjet e topave, njerëzit e plagosur dhe të vrarë, i sillej ndërmend vetëm gjak, gjak, gjak..

“Re të zeza baruti ngjiteshin ngadalë në qiell, ku dukeshin vende-vende yjtë. Këto re të zeza i sollën ndër mend luftën; buçitjet e topave, krisjet e pushkëve, flakërimet e hanxharëve. Trupa të shtrirë përtokë, të vrarë, të plagosur. Gjak, e gjak, e gjak! Në veshët e tij dëgjonte tingëllimin e hidhur të tërheqjes, që burizani i binte me zemër të plagosur. Shpirti i tij rëndohet, goditet më shumë. Retë po ngjiten në qiell. Skënderbeu, ballin rrudhur, po mendon, po mendon” F. 105.

Nga errësira Skënderbeut i hapet dera e çadrës ku po rrinte dhe vetëm po mendonte. Atij i shfaqej para një dritë e bardhë dhe një përfytyrim si një fytyrë njeriu. Ai trup njeriu sikur ishte i futur në tokë, kur afrohej ishte fytyra e një grua rrudha-rrudha, me sy të future e të nxirë, me flokë të lëshuar dhe të ngatërruar.

Lufta e Gjon Kastriotit kundër turqve dhe sidomos lufta e lavidshme e Gjergj Kastriotit të quajtur Skënderbe, patën një jehonë të madhe, sepse nga njëra anë luftonte një popull i vogël, populli shqiptar dhe nga ana tjetër kolosi më i madh i kohës, Perandoria Otomane. Kjo përpjekje e pabarabartë, por megjithatë ngadhnjimore, nuk mund të mos linte kudo gjurmë të thella. Pa fjalë, që kjo jehonë është ruajtur më shumë në gjirin e popullit tonë, të cilin kujtimi i Skënderbeut e ka shoqëruar si simbol të lirisë, si në ditë të mira, ashtu dhe në ditë të vështira, që prej vdekjes së tij e deri në ditët tona. Rëndësinë që ka pasur figura e heroit shqiptar dhe për luftën çlirimtare të popujve të tjerë e vërtettojnë librat dhe studimet e shumta, që janë bërë dhe po bëhen sot e kësaj dite, pas kaq vjetësh, nga të gjithë popujt e Ballkanit.

“Në errësirën e dendur hapet dera e çadrës. Një dritë e bardhë hyn andej e pas saj një diçka si një fytyrë njeriu, diçka si një trup i futur në tokë i afrohet Skënderbeut. Skënderbeu e shëkon mirë: një fytyrë gruaje rrudha-rrudha, me sy të future e të nxirë, me flokë të lëshuar dhe të ngatërruar. Është veshur me një plaçkë të zezë, lyer me gjak, çarë e grisur e aty-këtu të ngjitur pas trupit të dobët. Nuk ia shëkon dot këmbët. Nuk i duken. Toka sikur ia ka gllabatur në gjirin e saj. I tmerruar, Skënderi trim nuk lëviz dot, si i ngrirë përpara këtij mjerimi. Gruaja afrohet dhe më shumë. Fytyra e saj është tashti mbi kryet e Skënderbeut... Ay e sheh pa lëvizur fare. Fryma i është zënë, po zemra i rreh me të fortë. Ja, ajo po flet. Nga goja e saj mezi dalin fjalët. Buzët i dridhen e tingujt e ashpër me mundim i kap veshi i gjeneralit”, f. 106..

Mendja dhe zemra e Skënderbeut ishte e lidhur vetëm më tonë e tij shqiptare. Simbolika që i shfaqej atij është tepër interesante.

Lidhja e ngushtë e Skënderbeut me popullin simbolikisht reflektohet edhe në flamurin nën të cilin luftoi populli shqiptar-emblema e shqiponjës dykrerëshe, që simbolizon lidhjen e ngushtë të udhëheqësit me masën. Përhapja e saj i ka rrënjët në traditën e stërlashtë të popullit tonë. Ajo

¹ Aleks Buda, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij, në: Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Universiteti Shtetëror I Tiranës, Instituti I Historisë dhe I Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 19.

simbolizon luftën e popullit shqiptar për liri dhe rrugën e zhvillimit të tij historik. Nën këtë flamur luftoi populli shqiptar në epokën e Skënderbeut¹.

“Thotë ajo: ‘Jam Shqipëria, unë vetë Shqipëria!... Jam nëna jote. Prej meje ke lindur, nga vendet e mia ke marrë jetë ti, që kurrë gjer më sot nuk u kujtove një herë për mua, për nënën tënde, për Shqipërinë.’”, f. 106.

Atdheut i tij i del në çdo përfytyrim të Skënderbeut duke i bërë pyetjen që e mundonte prej vitesh heroin tonë, por ai e vë në gojën e Shqipërisë, duke kërkuar edhe llogari vetes së tij:

“A i pëlqekërka vallë një Shqiptari nderi gufonjës i sundonjësit armik?!”, f. 106.

Shqipëria dhe shqiptarët në shumë raste kanë qenë më dyshime në lidhje me birin e tyre, ai lindi në tokën e tij, por u rrit në tokën turke, ama gjithmonë në gjak kishte oksigjen shqiptar dhe rronte me shpresën se një ditë do t’i jepej rasti për t’i dal zot vendit që e lindi, siç edhe ndodhi.

“Gjergj Kastrioti im u fut edhe ay në kllapën e gënjeshtres?! Ku vajte ti, o gjykim? A të humbën vallë njerëzit? Oh, jo, nuk besoj... Kam shpresë, ngrohem me shpresë, rroj me shpresë! Oh! Jo! Gjergji, biri i Kastriotëve, nuk më ka harruar, pret kohën, pret rastin...”, f. 106.

Shqipëria dhe simbolet kombëtare janë në mendje të heroit tonë, simboli i tij kombëtar flamuri, i vjen nga Shqipëria atij i bërë copa-copash.

“Pushon pakëz këtu. Fut dorën në gjoks e nxjerr që andej një flamur kuqezi të grisur, bërë lecka-lecka dhe thotë: Ja flamuri!... Flamuri im është ky. Kanë dashur të ma marrin, të ma shuajnë fare. Unë s’i kam lënë, e kam mbrojtur, po ata, shëko si ma kanë bërë. Do të ma prishin edhe më shumë, po ngrihu, ngrihu, shpëtoma, se e dua, e dua shumë. Është flamuri im, i bijve dhe i bijave të mia: i kuq, zhgabë të zeze me dy krerë në mes”. F. 106.

Flamuri ynë kombëtar me shenjën e tij dalluese shqiponjën dykrenare ka një histori të lashtë dhe të lavdishme. Si shenjë ushtarake, shqiponja me një kokë njihet në vende të ndryshme qysh nga koha antike, midis tyre dhe në Perandorinë Romake. Në Perandorinë Bizantine, si shenjë e perandorëve, shqiponja u përdor në trajtën dykrenare, siç e interpretojnë, si simbol i sundimit mbi perëndimin dhe lindjen, të ndara pas vitit 395, ose të pushtetit shekullor dhe kishëtar².

Ekzistonte edhe një shpjegim tjetër i prejardhjes së shqiponjës së flamurit tonë, sipas këtij shpjegimi që është shumë i përhapur e popullor shqiponja e flamurit tonë ka kuptimin e një simboli etnik, e një “totem”i (domethënë të një kafshe të shenjtë, që konsiderohej si i pari i një fisi). Sipas këtij shpjegimi, shqiponja në flamurin lidhet me emrin “shqiptar”, bir i shqiponjës. Por, sipas mendimit tim, ky shpjegim nuk qëndron më do të shprehej Aleks Buda³.

Si gjithë sundimtarët e shekujve mesjetarë, edhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu kishte stemën familjare, e cila e pikturuar në flamur ose e vendosur në mburojë, simbolizonte pushtetin e vet. Sipas Marin Barletit, Skënderbeu mbante në luftë flamurin e Kastriotëve-një flamur të kuq të qëndisur me shqiponjën të zezë e dykrenore. Thonë pastaj se shqiptarët kur shikonin “flamurët e shqiponjave” vraponin pa i thirrur kush për të luftuar kundër armikut osman nën udhëheqjen e Skënderbeut⁴.

“Flamuri po farfalitet para hijes së zezë e shqiponja sikur merr jetë, sikur fluturon. Ajo fluturon mbi malet Arbërore, mbi bjeshkët, merr zemrën e Skënderbeut, e shpie mbi to, e shëtit e kthehet prapë në flamur”, f. 106.

¹ Kristo Frashëri, *Flamuri i Skënderbeut*, në: “Drita”, nr. 53, 31 dhjetor, 1967, 3.

² Aleks Buda, *Pse flamuri ynë e ka shqiponjën me dy krerë*, në: “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 72.

³ Aleks Buda, *Pse flamuri ynë e ka shqiponjën me dy krerë*, në: “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 72-73.

⁴ Aleks Buda, *Pse flamuri ynë e ka shqiponjën me dy krerë*, në: “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 74.

E flamuri po mbështillet prapë, ngadalë, madhështor! Hija e zezë po largohet, po ikën, po çduket. Skënderbeu po shëkon..

...Ja, në qiell vetëtimi ylli i dritës. Skënderbeu u zgjua nga ëndrra e tij. Qielli është i kaltër, i ëmbël. Pak re kanë mbetur atje, kujtime të mbytura të mbrëmjes. Burizani jashtë i bie burijes për ngritje. Lart, në qiell, po fluturon krenare një shqiponjë e zezë. Skënderbeu ngrihet në këmbë, i afrohet dritares, e përshendet shqiponjën e i thotë:

Shqiponja ka simbolizuar qysh në kohët më të lashta fantazinë e popujve të ndryshëm madhështinë, fuqinë, shkathtësinë dhe mprehtësinë. Nga letërsia popullore me kohë hyri edhe në letërsinë artistike.

Skënderbeu i shkruante princit Italian J. A. de Ursinis, shqiptarët ishin të ndërgjegjshëm se ishin pasardhësit e epirotëve të lashtë dhe stërnipërit e Pirros së famshëm. Shkrimtari i vjetër grek, Plutarku, thotë se pas fitores së bujshme që kori Pirroja kundër maqedonëve, epirotët e përshëndetën me mbiemrin “shqiponjë”. Pirroja u përgjigj: “Është merita juaj që unë jam shqiponjë, dhe sit ë mos jem kur ju me armët tuaja më kini ngritur lart si me krahë të shpejta? Sipas fjalëve të Pirros shqiponja me krahë të hapura simbolizon lidhjen e ngushtë të udhëheqësit me masën. Shqiponja vazhdimisht ka jetuar në malet e Shqipërisë; përherë ka fluturuar mbi kokat e shqiptarëve¹.

“Shko, shqiponjë, shko shpjeri përshëndetjen time Shqipërisë. Fluturo, shko fluturo mbi fushat, mbi malet e Arbërisë. I thuaj se Gjergj Kastrioti prapë do të vijë të punojë për të, do të vijë që ta shpëtojë. I thuaj se ay nuk i do nderimet e huaja. I duken të hidhura. Ato pak të vendit të tij i janë të ëmbla. Shqiponja sikur e dëgjoji e ia nisi fluturimin për në perëndim. Ajo përçante ajerin, ikte e ikte larg, e biri i Kastriotëve po lëshonte pika lotësh përpara dritares së çadëres së tij!... f. 107.

¹ Kristo Frashëri, *Flamuri i Skënderbeut*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969, f. 77.